

CIG

**COUNCIL FOR
INCLUSIVE
GOVERNANCE**

BASHKËSIA SERBE NË KOSOVË
Sfidat dhe mundësitë

Council for Inclusive Governance

New York, July 2010

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (anglisht CIG) ka filluar një iniciativë në lidhje me politikat mbi qëndrueshmërinë e bashkësisë serbe në Kosovë. Programi përfshin një sërë debatesh me krerët politikë të serbëve të Kosovës dhe përfaqësuesve të shtetit serb, përgjegjës për politikën ndaj Kosovës. Qëllimi i iniciativës është arritja e një mendimi inovativ si dhe kërkimi i një mënyre të re të veprimit politik për të përmirësuar situatën politike dhe ekonomike të bashkësisë serbe. Iniciativa financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Zvicrës.

CIG ka filluar këtë iniciativë përmes një varg diskutimesh individuale dhe të përbashkëta në tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues qeveritarë, politikanë dhe analistë në Prishtinë dhe Beograd, të mbajtura në periudhën nga 22 maji deri më 5 qershor të vitit 2010. Qëllimi i këtyre diskutimeve ka qenë krijimi i një pasqyre analitike të gjendjes aktuale të bashkësisë serbe në Kosovë si dhe të përcaktohet mënyra e fushëveprimit të më tejme. Pjesëmarrësit në diskutime prandaj kanë dhënë kontributin e tyre përmes angazhimeve vetanake. Në këtë kuadër raporti përmban mendimet, idetë dhe qëndrimet e pjesëmarrësve, por nuk ofron një pasqyrë të përgjithshme të diskutimeve. CIG mban ekskluzivisht përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

Ekziston një konsensus i gjerë midis serbëve të Kosovës dhe politikanëve serbë se realiteti politik dhe ekonomik i bashkësisë serbe në Kosovë është duke u përmirësuar. Siguria, qasja në shërbime, në sistemin e arsimit dhe raportet me bashkësitë tjera po përmirësohen vazhdimisht. Megjithatë, pjesëmarrësit pajtohen se shumë çështje thelbësore akoma kërkojnë zgjidhje ku ndër më të nevojshmet janë: zhvillimi dhe reformimi i udhëheqjes politike të serbëve të Kosovës, rishikimi i politikës dhe strategjisë për mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe ekonomike, ndërsa është shumë e nevojshme të rritet veçanërisht ndihma politike dhe ekonomike me qëllim të ndërtimit të një bashkësie të vetë qëndrueshme.

Udhëheqja politike

Ndonëse procesi i konsolidimit është i vazhdueshëm, partitë politike të serbëve të Kosovës edhe më tej janë në tensione politike: politikanët edhe më tej ndërrojnë partitë, formohen parti të reja dhe iniciativa qytetare, ndërsa brenda partive në rritje është dhe debati politik. Megjithatë, partitë politike serbe në Kosovë nuk dallojnë nga të tjerat. Partitë politike dhe iniciativat politike të bashkësive tjera gjithashtu vazhdojnë të ndahen dhe rigrupohen. Ish politikanë dhe armiq politikë themelojnë aleanca dhe nga njëherë koalicione të çuditshme politike shtetërore, ndërsa ndodh që ish aleatët dhe miqtë e dikurshëm shndërrohen në armiq politikë. Shumëkush beson se këto ndarje para së gjithash bazohen në interesa personale dhe partiake më parë se në dallime politike dhe ideologjike.

Ndonëse debati publik ka të bëjë me politikat dhe strategjitë, votuesit e të gjitha bashkësive në Kosovë, nisur nga rezultatet e shumë anketave dhe analizave, besojnë se përfaqësuesit e tyre politikë vazhdojnë të mendojnë vetëm për mbajtjen e tyre sa më të gjatë në pushtet, me qëllim të rritjes së përfitimit personal në kurriz të njësive të tyre zgjedhore. Votuesit kështu bëhen cinikë, duke i parë liderët partiakë si egoistë dhe të padobishëm. Në anën tjetër për pasojë besimi në institucionet politike dhe partiake po shkon duke u zvogëluar dukshëm. Kështu edhe në mesin e bashkësisë shqiptare është shënuar një zvogëlim i dukshëm i daljes së elektoratit në zgjedhje.

Megjithatë, politika partiake e serbëve të Kosovës, nuk konteston vetëm në pushtet, ajo gjithashtu është çështje e zgjedhjes politike: të bëhesh pjesë e institucioneve të Kosovës apo ti bojkotosh edhe më tej ato, për ti forcuar më shumë institucionet serbe të njohura si institucione “paralele”.¹ Disa parti politike serbe kanë vendosur të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare të Kosovës dhe ti bashkohen qeverisë së Kosovës, ndërsa disa të tjera kanë zgjedhur themelimin e institucioneve paralele serbe, në fushën e shëndetësisë, arsimit, por edhe në dhënien e dokumenteve të identifikimit për qytetarët serbë të Kosovës. Ekziston dhe një grup tjetër i cili thotë se serbët duhet të bojkotojnë institucionet nacionale të Kosovës, parlamentin dhe qeverinë, por jo dhe institucionet komunale. Ata thonë: serbët duhet të dalin në zgjedhjet komunale. Problem është çështja nëse kjo ndarje politike brenda bashkësisë serbe dëmton interesat e serbëve dhe në mos ata në këtë mënyrë po dëmtojnë ndërtimin e entitetit politik demokratik dhe pluralist. Varësisht nga përgjigja në këtë pyetje, partitë politike serbe do të duhej ose të unifikojnë politikën e tyre si një lidhje politike unik, ose të vazhdojnë me forcimin e kapaciteteve brenda partive ekzistuese.

Mendimi dominues është që përpjekjet dhe mjetet politike duhet orientuar drejt forcimit të kapaciteteve, më parë se në unifikimin e partive politike serbe. Në favor të kësaj është dhe argumenti se dallimet politike prodhojnë ide të reja dhe kontribuojnë në ndërtimin e partive të shëndosha e demokratike. Politikanë nga i gjithë spektri politik besojnë se udhëheqja e serbëve të Kosovës duhet të ngjallet dhe forcohet me një tempo të shpejtë, në mënyrë që problemet e akumuluar në dhjetë vitet e kaluara të zgjidhen. Ata pajtohen për nevojën e harmonizimit të politikës dhe strategjisë, por nuk kanë një pajtim për atë se çfarë duhet harmonizuar në mënyrë precize. Shumica kanë potencuar faktin se kjo mund të arrihet vetëm përmes një debati fleksibil intensiv dhe pragmatik midis subjekteve politike dhe jopolitike serbe.

Në kuadër të diskutimeve të zhvilluara, janë vijëzuar tre skenarë të mundshme për udhëheqjen politike serbe:

Skenari i parë është i bazuar në idenë se nevojitet një pjesëmarrje e fuqishme e bashkësisë serbe në zgjedhjet në Kosovë, në mënyrë që të mund të ruhen dhe mbrohen interesat afatgjata të bashkësisë serbe. Një opsion i tillë do të kishte prodhuar një udhëheqje politike të fortë dhe përgjegjëse e cila do të mundësonte përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe të interesave politike e shoqërore të serbëve. Pjesëmarrja e serbëve në zgjedhje dhe hyrja në një koalicion qeverisës, do tu mundësonte atyre të shndërroheshin në forcën e tretë dhe mbase të dytë më të madhe politike në parlamentin e Kosovës, ndërsa disa thonë se ky bllok politik do të ishte një faktor i patejkalueshëm edhe gjatë procesit të formimit të qeverisë i cili zakonisht bëhet me vështirësi në Kosovë. Megjithatë, shumë vetë parashikojnë se një skenar i tillë është i pamundshëm në periudhën afatshkurtër duke marrë parasysh kontestin që ekziston midis Beogradit dhe Prishtinës.

¹ Këto institucione në Kosovë janë krijuar para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në zgjedhjet serbe në maj të 2007. Institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare atyre ju referohen si institucione “paralele”.

Skenari i dytë parashikon vazhdimin e bojkotimit të institucioneve qendrore të Kosovës, por një pjesëmarrje më të madhe në institucionet e nivelit lokal. Pjesëmarrja masive e zgjedhësve serbë në zgjedhjet lokale të 2010-ës në komunën e re të Parteshit karakterizohet si fillim i kësaj strategjie. Sipas të dhënave zyrtare, pjesëmarrja në zgjedhje në komune e re të Parteshit ka qenë 65 për qind gjë që është 20 për qind më e madhe se mesatarja e daljes së shqiptarëve në zgjedhjet lokale të vitit 2009. Dalja e serbëve në zgjedhjet lokale të komunës së Graçanicës dhe Shtërpçës gjithashtu ka qenë solide. Shumica e njerëzve kanë vlerësuar se pjesëmarrja në zgjedhjet lokale në këto komuna ka qenë një vendim pragmatik: sikur serbët të kishin bojkotuar zgjedhjet në Shtërpçë dhe Graçanicë, në këto dy komuna të banuara me shumicë serbe, kryetarët e komunave do të zgjidheshin shqiptarë.

Opsioni i tretë parashikon vazhdimin e situatës së tanishme, ku shumica e serbëve bojkotojnë edhe më tej pjesëmarrjen në institucionet e Kosovës. Ajo rreth së cilës janë pajtuar të gjithë pjesëmarrësit e debateve ka qenë konstatimi se udhëheqja politike e serbëve në Kosovë nuk ka shumë kohë për të humbur pasi zgjedhja dhe vendimet duhet të merren sa më shpejt prej tyre.

Strategjia dhe politika

Në kontest të tranzicioneve politike në të cilin gjendet bashkësia serbe, shpesh është vështirë të rumbullakohen politikat kohezive dhe koherente afatgjata. Situata e serbëve në Kosovë është kaq jostabile sa vetëm një incident ndërtnik mund të bëhet shkas për konflikte të mëdha duke rrënuar brenda një dite atë që është arritur brenda një viti – prandaj është shumë vështirë të formulohet dhe zbatohet politika koherente. Përveç kësaj, efektet politike zakonisht nuk bien në sy shpejt, përveç në rastet kur politika ka qenë e orientua në staza të gjata, ose në rastin kur ekzistojnë disa prej parakushteve. Përkundër faktit se politika serbe ka dy vite që është aktive, situata vazhdon të jetë edhe më tej e paqëndrueshme. Politika aktuale serbe e tillë çfarë është ka dy vjet që vepron, ndërkohë që situata akoma vazhdon të jetë jostabile. Pra është vështirë të vihet në përfundim se strategjia dhe politika e bashkësisë serbe në Kosovë ka qenë produktive ose jo, apo nëse politikat alternative do të jepnin rezultate më të mira.

Procesi i identifikimit të problemeve gjithmonë është më i lehtë se formulimi i zgjidhjeve të tyre. Politikanët serbë me lehtësi identifikojnë problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen bashkësitë e tyre, por çështja komplikohet kur është në pyetje gjetja e rrugëve për zgjidhjen e tyre. Ata gjithashtu ballafaqohen me një mungesë të një përshkrimi të hollësishëm të qëllimeve të tyre politike dhe rolit të institucioneve në funksion të ruajtjes së interesave të bashkësisë serbe. Qëllimet e një politike të tillë dhe institucioneve të tilla nganjëherë janë të paqarta. Është propozuar që më shumë njerëz të rinj që e kuptojnë këtë situatë të ndërlikuar politike, përfshirë edhe ata njerëz që tani nuk pajtohen me qëndrimin aktual të shumicës, të përfshihen në politike dhe debate politike.

Hapi i parë në përcaktimin e orientimit politik që do duhej të merrej është që të bëhet një analizë e prioriteteve dhe mangësive të opsioneve politike të deritashme, që të identifikohen edhe një herë pengesat që deri më tani janë shfaqur, si dhe në anën tjetër, të vlerësohet kualiteti i punës që kanë bërë institucionet e ngarkuar për zbatimin e kësaj politike. Qëllimi i gjithë kësaj, nëse është e nevojshme - do të ishte të bëhej modifikimi i veprimit politik si dhe përmirësimi i efikasitetit të institucioneve.

Gjithashtu, politika do të duhej që ti përshtatej kontestit specifik politik. Serbët në veri dhe serbët që jetojnë në jug të Kosovës jetojnë në rrethana të ndryshme politike, prandaj si rezultat, është i pashmangshëm fakti i përshtatjes së politikës kreative me situatën specifike. Faktor vendimtar i këtyre dallimeve është pozicioni gjeografik. Derisa serbët në veri kanë një qasje të drejtpërdrejt në institucionet dhe shtetin serb, ndërsa kanë edhe institucione të pavarura me të cilat mbulojnë veriun, enklavat serbe në jug të cilat jetojnë të rrethuar nga lokalitete shqiptare, mbështeten jo vetëm në institucionet serbe por edhe në ato ndërkombëtare dhe në institucionet e Kosovës. Si rezultat, institucionet serbe në jug nuk janë efikase si ato në veri në zgjidhjen e problemeve të përgjithshme si është për shembull furnizimi me energji elektrike. Ç'kycjet e energjisë elektrike vitet e kaluar në enklavat serb në jug të Kosovës, i kishin kontribuar rrezikimit të bashkësisë serbe në ato pjesë të Kosovës. Të lënë në errësirë për javë të tëra, serbët në jug nuk kishin alternativa tjetra pos të bisedonin me KEK-un në mënyrë që të gjendej një zgjidhje. Qeveria e Serbisë për ca kohe ka bërë verifikimin e rolit të institucioneve serbe në këto enklave dhe për pasojë kishte ndaluar punën e institucioneve lokale në disa prej komunave në pjesën jugore, të cilat nuk kishin kurrë farë rëndësie për banorët serbë. Shumica e politikanëve serbë në Kosovë kishin përshëndetur këtë vendim duke thënë se mjetet që përdoren për financimin e këtyre strukturave politike paralele tani mund të përdoren për financimin e disa projekteve në interes të banorëve serbë.

Pra problemet që një serb ka në Kosovë varen shumë nga vendi apo hapësira gjeografike ku ai jeton. Fjala vjen serbët në Shtërpcë ballafaqohen me lloj-lloj problemesh për dallim prej serbëve që jetojnë në veri të Mitrovicës. Për këtë arsye është e vështirë të përgjithësohen problemet me të cilat ballafaqohet bashkësia serbe si tërësi në Kosovë. Në këtë kontekst, politikën duhet përshtatur problemeve specifike të cilat i ka çdo rajon. Një situatë e tillë shtron nevojën e hyrjes së politikanëve lokalë në procesin e politikëbërjes në mënyrë që të shihet edhe kontributi i tyre.

Derisa angazhimi i brendshëm i spektrit të gjerë të serbëve të Kosovës është parakusht për konstituimin e një strategjie dhe politike adekuate, ndihma politike dhe financiare e Beogradit është e nevojshme. Roli i Beogradit është i pazëvendësueshëm në zgjidhjen e çështjeve politike dhe institucionale në komunat e mëdha që shtrihen në jug të Kosovës. Komunat Graçanicë, Shtërpcë dhe Partesh kanë nga dy parë institucione dhe të dyja thonë se kanë legjitimitetin e popullit. Edhe pse disa marrëveshje të përkohshme të pashkruara janë arritur për mos pengimin e njëra tjetrës në punën e tyre, edhe më tej ekziston një potencial për konflikte në të ardhmen, që do të ishin në dëm të banorëve serbë. Si një zgjidhje e përkohshme është propozuar bashkëpunimi i këtyre institucioneve për të ofruar shërbime dhe veprimtari në interes të banorëve serbë. Është propozuar edhe një bashkëpunim në projekte të vogla infrastrukturore, si është ndërtimi i rrugëve lokale dhe kanalizimeve. Megjithatë, kjo mënyrë bashkëpunimi mund të shërbejë vetëm si një zgjidhje e përkohshme. Pjesëmarrësit pajtohen se zgjidhjet afatgjata janë para së gjithash në interesin e vetë njerëzve nga këto komuna

Qëndrueshmëria politike dhe ekonomike

Qëndrueshmëria politike dhe ekonomike e bashkësisë serbe në Kosovë duhet shqyrtuar në kontest të gjerë ekonomik, sepse shqyrtimi ngushtë mund të prodhojë një analizë të gabuar politike. Jo vetëm bashkësia serbe në Kosovë por edhe e tërë shoqëria kosovare është e

mbështetur fuqimisht në donacione, qofshin këto prurjet nga diaspora shqiptare, qofshin pagat sociale që paguhen nga qeveria e Serbisë për bashkësinë serbe. Zyrtarisht, shkalla e papunësisë në Kosovë është më e madhe se 45 për qind. Ndonëse nuk ka të dhëna të sakta për bashkësinë serbe, shkalla e papunësisë edhe në mesin e kësaj bashkësie duhet të jetë po kaq e lartë. Cilado qoftë bashkësi me një shkallë kaq të madhe të papunësisë mund të definohet si bashkësi e paqëndrueshme në një afat të gjatë kohor, pavarësisht nga përkatësia etnike.

Ndonëse fare pak mund të bëhet në përmirësimin e situatës politike pa një stabilitet politik dhe investime të rëndësishme, megjithatë ekziston një hapësirë e mjaftueshme për aktivizimin e potencialeve ekonomike të bashkësisë serbe. Një aktivitet më i madh ekonomik i bashkësisë serbe do të kishte për pasojë një pagesë më të madhe të dividendës financiare. Kjo do të stimulonte rritjen e sistemit ekonomik duke vënë në radhë të parë në funksion resurse të pashfrytëzuar njerëzore, ndërsa do të ndalte në tërësi “ikjen e trurit”. Shumica e pjesëmarrësve në debatet tona kanë përmendur faktin se shumë të rinj të arsimuar serbë po shpërngulen në Serbi për shkak të mungesë së perspektivës dhe vendeve të punës në vendbanimet ku jetojnë në Kosovë. Nëse nuk parandalohet kjo dukuri, ky fakt mund të prodhojë pasoja afatgjata për bashkësinë serbe. Edhe bashkësia shqiptare ka të njëjtin problem me ikjen e trurit, por për të pasojat mund të jenë më të vogla duke pasur parasysh shkallën demografike aktuale dhe pamundësinë e banorëve të Kosovës të lëvizin dhe punojnë në vendet perëndimore.

Deri sa nuk vendoset baza e prodhimit ekonomik, pagat sociale të qeverisë serbe për serbët në Kosovë, janë të rëndësishme thelbësore për mbijetesën e tyre dhe duhet të vazhdojnë të paguhen. Megjithatë, Serbët në Kosovë së bashku me qeverinë serbe duhet të mendojnë strategjinë e cila mban dhe gjallëron aktivitetet ekonomike të orientuara drejt shfrytëzimit të potencialeve intelektuale dhe ekonomike të bashkësisë serbe në Kosovë.

Ideja për subvencionimin e aktiviteteve ekonomike do të duhet të merret nga politikanët serbë në Beograd dhe Prishtinë. Një shembull për këtë është subvencionimi i një fabrike për përpunimin e qumështit në komunë me shumicë serbe në Partesh. Megjithatë, subvencionimet për aktivitete fitimprurëse nuk janë të qëndrueshme në planin afatgjatë. Në vend të kësaj ofrimi i kredive me interes të ulët për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe ofrimi i ndihmës është një qasje që përmirëson pozitën ekonomike të bashkësisë serbe dhe aktivizon potencialin e saj njerëzor.

Përfundim

Euforia dhe retorika nacionaliste midis bashkësive në Kosovë është duke u fikur me një tempo të shpejtë si asnjëherë më parë, ndërsa çështjet e mbijetesës po bëhen prioritet. Duke përjashtuar politikanët, reagimet publike në ta ashtuquajtura çështje nacionale nuk janë tashmë të forta dhe kjo mund të dëshmohet me faktin se për herë të parë bujqit dhe sindikatat e ndryshme po organizojnë protesta në qendër të Prishtinës për të kërkuar kushte më të mira pune dhe jete. Sipas shumë anketave të ndryshme, lista e prioriteteve për serbët edhe për shqiptarët në Kosovë është e njëjtë. Për të dy bashkësitë, punësimi dhe mirëqenia ekonomike janë vënë në krye të prioriteteve. Për këtë arsye është më se e domosdoshme intensifikimi i veprimit politik në funksion të ndërtimit të një politike efektive duke siguruar realizimin e saj me qëllim të zgjidhjes praktike të problemeve në shoqëri.